



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 23, Datë 30.01.2026

MBI

**DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 190, DATË
12.08.2025 “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “ENERGOVIA.ALBANIA” SH.P.K.
NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar;; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 30.01.2026, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Monitorimit të Tregut dhe Mbikëqyrjes së të Licencuarve, me nr. 113/2 prot., datë 27.01.2026, “Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 190, datë 12.08.2025 “Mbi licencimin e shoqërisë “Energovia.Albania” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë “Energovia.Albania” sh.p.k.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 190, datë 12.08.2025, ka licencuar shoqërinë “Energovia.Albania” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 5 (pesë) vjeçar.
- Referuar pikës 2 të vendimit nr. 190/2025 dhe sa konstatuar në këtë vendim, shoqëria “Energovia.Albania” sh.p.k., brenda datës 01.02.2026, duhet të depozitojë në ERE kontratat e rinovuara për shërbimet e jashtme, ose çdo dokument tjetër në lidhje me disponimin e stafit teknik. (shërbime ligjore dhe të kontabilitetit)
- Gjithashtu në pikën 3 të këtij vendimi është përcaktuar se ky vendim është objekt rishikimi në lidhje me plotësimin ose mosplotësimin e pikës 2 të tij.

2. Korrespondenca dhe Dokumentacioni i Depozituar nga Shoqëria

- ERE, në kuadër të ndjekjes së kushteve të vendimit nr. 190/2025, me shkresën nr. 3033 prot., datë 12.12.2025, i ka kërkuar shoqërisë “Energovia.Albania” sh.p.k. depozitimin e kontratave të rinovuara për shërbimet e jashtme, me afat vlefshmërie që të mbulojë gjithë periudhën e licencës, deri më 12.08.2030.
- Shoqëria, me emailin e protokolluar në ERE me nr. 3033/1 prot., datë 22.12.2025, ka depozituar:
 - “Kontratën për ofrimin e shërbimeve të kontabilitetit”, të lidhur më datë 01.12.2025, ndërmjet shoqërisë “Energovia.Albania” sh.p.k. dhe Audituesit Ligjor/Ekspertit Kontabël Z. A. H., me afat vlefshmërie deri më 31.08.2030;
 - “Kontratën për ofrimin e shërbimeve ligjore”, të lidhur më datë 01.12.2025, ndërmjet shoqërisë “Lwx Business” sh.p.k. dhe shoqërisë “Energovia.Albania” sh.p.k., me afat vlefshmërie deri më 31.08.2030.
- ERE, me emailin e datës 06.01.2026, të protokolluar me nr. 23, datë 06.01.2026, në zbatim të nenit 8, pika 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin,

transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, i ka kërkuar shoqërisë që dokumentacioni i depozituar të paraqitet në formën e kërkuar nga kjo rregullore.

- Shoqëria, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 113/1 prot., datë 22.01.2026, ka depozituar kontratat origjinale për shërbimet e sipërcituara.

3. Analiza Ligjore dhe Vlerësimi

- Referuar dokumentacionit të depozituar për shërbimet e jashtme, konkretisht kontratës për ofrimin e shërbimeve të kontabilitetit dhe kontratës për ofrimin e shërbimeve ligjore, si dhe kërkesës së “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” (pika 1.2, gërma “c”), vlerësohet se shoqëria ka përmbushur kushtin e vendosur në pikën 2 të vendimit nr. 190/2025, pasi afati i vlefshmërisë së kontratave (deri më 31.08.2030) mbulon periudhën e licencës (deri më 12.08.2030).

4. Nevoja për Ndryshimin e Vendimit

- Në mbështetje të nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon se një akt administrativ mund të ndryshohet ose shfuqizohet nga organi që e ka nxjerrë atë, vlerësohet se pika 2 e vendimit nr. 190/2025 duhet të shfuqizohet.
- Me shfuqizimin e pikës 2, nuk gjen më zbatim edhe pika 3 e vendimit nr. 190/2025, ndaj lind nevoja për shfuqizimin e saj.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Miratimin e disa ndryshimeve në vendimin e ERE-s nr. 190, datë 12.08.2025, si vijon:
 - a) Pika 2 shfuqizohet;
 - b) Pika 3 shfuqizohet.
2. Drejtoria e Monitorimit të Tregut dhe Mbikëqyrjes së të Licencuarve, të njoftojë shoqërinë “Energovia.Albania” sh.p.k., lidhur me vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI